

**LIGJ**  
**Nr. 87/2022**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 10 383, DATË 24.2.2011, “PËR SIGURIMIN E  
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas shkronjës “ë”, të pikës 2, të nenit 5, shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 mijë lekë në muaj, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2023.

Miratuar më datë 22.12.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 1, datë 6.1.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**